



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 17482 Prot.

Tiranë, më 27 . 7 .2017

Lënda: Për saktësimin e procedurave të lidhura me zbatimin korrekt të nenit 122, pika 1, gërma h), dhe nenit 127, pika 3, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pikave referuese të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale Tatimore

Drejtorisë së Hetimit Tatimor Këtu

Drejtorisë së Hetimit Tatimor – Rajoni Qëndror

Drejtorisë së Hetimit Tatimor – Rajoni Verior

Drejtorisë së Hetimit Tatimor – Rajoni Jugor

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 10, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me problematikat e konstatuara për sa i takon zbatimin të nenit 127, pika 3, dhe të nenit 122, pika 1, gërma h), të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikave 127.3, 51.3, 58.2, 58.3, 58.4 dhe 122.4, të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve e sheh të nevojshme hartimin dhe zbatimin e këtij udhëzuesi nga administrata tatimore.

Përmbajtja: neni 127, pika 3: Në rast se organet tatimore kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare, organet tatimore kanë të drejtë t'ia

sekuestrojnë dokumentacionin, pajisjet kompjuterike dhe fiskale dhe mjete të tjera të mbajtjes së dokumentacionit të tatimpaguesit në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Përmbajtja: neni 122, pika 1, gërma h): Tatimpaguesi *“mban ose përdor pajisje fiskale apo sisteme të monitorimit të qarkullimit, të cilat nuk janë në përputhje me këtë ligj apo aktet nënligjore në zbatim të tij, dënohet me konfiskim të mallrave gjendje. Gjithashtu, në përputhje me nenin 116, të këtij ligji, administratat tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin”.*

1. Në rastet kur organet tatimore kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare dhe gjendet në kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 127, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Pë procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, procedura që do të ndiqet është si më poshtë:

- Të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacionin për gjendjen e tij ekonomike dhe financiare mund të jenë:
 - Përdorimi i printerave jofiskalë në pikat e shitjes, të lidhura me një njësi kompjuterike;
 - Lëshimi i faturave jotatimore, të lidhura me një njësi kompjuterike, të përdorura gjatë tregëtimit, ruajtjes apo transportit të mallrave;
 - Përdorimi i faturave të zakonshme Fletë - Hyrje, Fletë - Dalje, etj, në tregtimin, ruajtjen dhe transportin e mallrave;
 - Kupona të tjerë jofiskalë;
 - Të dhëna të tjera.

1.1 Nëse punonjës të administratës tatimore (Drejtorisë Rajonale Tatimore apo Drejtorisë së Hetimit Tatimor) gjatë ushtrimit të detyrës së tyre funksionale konstatojnë, krijojnë bindjen, apo kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacionin për gjendjen e tij ekonomike dhe financiare, mban dhe përdor pajisje jo fiskale (printera) dhe ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 127, të ligjit të mësipërm, menjëherë mbajnë aktin e konstatimit, ku cilësojnë objektin për të cilin do të kryhet sekuestrimi (dokumentacion, pajisje jo fiskale, njësi kompjuterike apo mjete të tjera) si edhe mbajnë edhe procesverbalin përkatës të konfiskimit të mallrave gjendje për rishitje, duke i cilësuar për çdo artikull dhe në sasi. Akti i Konstatimit nënshkruhet nga punonjësit tatimorë që e kanë hartuar atë dhe nga tatimpaguesi i konstatuar me shkelje ose përfaqësuesi i tij. Pas kësaj, punonjësit tatimorë informojnë, njoftojnë eprorin e drejtpërdrejtë për rastin e konstatuar në ambientin e ushtrimit të veprimtarisë së tatimpaguesit.

1.2 Nëse administrata tatimore ka të dhëna të besueshme, (të siguruara nga denoncime të qytetarëve, nga verifikime apo konstatime të punonjësve brenda administratës tatimore etj.) se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike - financiare dhe ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën

3, të nenit 127, të ligjit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i cili ka në administrim tatimpaguesin apo Drejtori i Hetimit Tatimor i Rajonit të juridiksionit sipas rastit, nxjerr urdhërin për sekuestrimin e pajisjeve dhe/apo dokumentave, të cilët fshehin situatën reale dhe ekonomike të tatimpaguesit.

1.3 Në rastet kur denoncimi është bërë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtori i Hetimit Tatimor, i përcjell denoncimin për veprim sipas këtij Udhëzuesi, Drejtorit të Hetimit Tatimor të Rajonit, i cili ka në administrim tatimpaguesin brenda ditës së punës në të cilën denoncimi është bërë në D.P.T. Komunikimi për të përcjellë denoncimin për njohje dhe veprim, mund të bëhet në rrugë zyrtare, elektronike, me telefon etj.

1.4 Në rastet kur Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT dhe Drejtoritë Hetimore Rajonale gjatë punës së tyre, në bazë të dyshimeve të arsyeshme, konstatojnë se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare dhe ndodhet në kushtet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 127, të ligjit të mësipërm, pas miratimit të Drejtorit të Hetimit Tatimor në DPT (miratimi duhet të jetë shkresor ose elektronik), Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT apo Drejtoria e Hetimit në Rajonin përkatës, kryen bllokimin dhe sekuestrimin e pajisjeve dhe/apo dokumentave, për të cilat dyshohet se fshehin situatën reale dhe ekonomike të tatimpaguesit. Sekuestrimi i pajisjeve, duhet të bëhet për një kohë sa më të shkurtër, por jo më vonë se 24 orë nga koha në të cilën është evidentuar fshehja apo shkelja tatimore.

1.5 Sekuestrimi i pajisjeve dhe/apo dokumentacionit shoqërohet me një procesverbal të posaçëm sekuestrimi, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit të sekuestrimit dhe përfaqësuesi i tatimpaguesit.

2. Drejtoria e Hetimit Tatimor përkatëse njofton Drejtorin e Drejtorisë Rajonale Tatimore, që ka në administrim tatimpaguesin, për bllokimin e kryer, i cili pas marrjes së njoftimit, brenda ditës së punës ngre grupin e verifikimit të përmbajtjes së njësisë kompjuterike, si dhe lajmëron me shkresë zyrtare tatimpaguesin, të cilit i janë bllokuar pajisjet dhe/apo dokumentet lidhur me vlerësimin që do t'u bëhet atyre.

2.1 Dokumentacioni dhe/apo pajisjet e sekuestruara nga Drejtoria Hetimore përkatëse, që mund të përmbajnë të dhëna në formë elektronike i dorëzohen menjëherë grupit të verifikimit të ngritur nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i ngritur sipas pikës 3.1, të këtij udhëzuesi.

2.2 Në rast se pas nxjerrjes së urdhërit të sekuestrimit nga ana e Drejtorit Rajonal apo Drejtorit të Hetimit të Rajonit përkatës, në ambientet e tatimpaguesit nuk gjendet njësia kompjuterike apo dokumentacioni që është vendosur për tu sekuestruar, ky urdhër do të ngelet në fuqi dhe do të ekzekutohet në çdo moment që do të konstatohet se tatimpaguesi ka rikthyer njësinë kompjuterike apo dokumentacionin që është vendosur për tu sekuestruar. Në këto raste, administrata tatimore kryen

verifikime të nevojshme, për një rrjedhje të mundshme të informacionit, si dhe ndërmerr kontrole të shpeshta dhe të vazhdueshme tek tatimpaguesi.

Në rast se tatimpaguesi nuk bashkëpunon, apo kundërshton sekuestrimin e njësisë kompjuterike apo dokumentacionin që është vendosur për tu sekuestruar, kërkohet mbështetja e organeve të policisë së shtetit, si dhe bëhet kallëzim penal në prokurori sipas nenit 131, pika 1, (e) dhe pika 2 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar.

Dokumentacioni dhe/apo pajisjet e sekuestruara që mund të përmbajnë të dhëna në formë elektronike i dorëzohen menjëherë grupit të verifikimit të ngritur nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore sipas pikës 3.1, me proces verbal dorëzimi brenda ditës së punës në të cilën sekuestrimi është kryer.

3. Paisjet dhe/apo dokumentacioni i sekuestruar i nënshtrohen procedurës së verifikimit të përmbajtjes së tyre brenda një afati prej shtatë ditësh kalendarike, duke filluar nga dita e sekuestrimit.

3.1 Përbërja e grupit të verifikimit përcaktohet nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore në administrimin e të cilës është tatimpaguesi, në përbërje të të cilit duhet të ketë minimalisht një inspektor kontrolli, një inspektor të kualifikuar të IT dhe një punonjës të strukturave të hetimit tatimor. Gjatë procesit të verifikimit do të jetë edhe tatimpaguesi, apo një përfaqësues i autorizuar nga tatimpaguesi, të cilit i është sekuestruar paisja nën kontroll, i cili ka marrë dijeni nëpërmjet kopjes së proces verbalit të sekuestrimit dhe njoftimit për vlerësimin e pajisjes së sekuestruar. Kur shihet e nevojshme nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore mund të kërkohet që antarët e grupit të verifikimit të përmbajtjes së pajisjes të asistohen edhe nga punonjës të kualifikuar të D.P.T - së.

3.2 Në rast të mosparaqitjes së tatimpaguesit apo të personit të autorizuar sipas afateve të përcaktuara më sipër, dhe në kushtet e marrjes dijeni prej tij nëpërmjet proces verbalit të sekuestrimit, verifikimi kryhet edhe pa praninë e tatimpaguesit.

3.3 Grupi i punës i ngritur sipas pikës 3.1, të këtij Udhëzuesi, pas kryerjes së verifikimit që i bën dokumentacionit dhe/apo pajisjeve jofiskale kompjuterike të sekuestruara, përgatit Raportin për Drejtorin e Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, brenda një afati prej 7 (shtatë) ditë kalendarike.

3.4 Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, brenda tre ditëve, pas dorëzimit të raportit nga grupi i verifikimit, e dërgon raportin e ekspertizës në Drejtorinë e Kontrollit tatimor, e cila po brenda tre ditëve duhet të procedojë sipas rregullave të përcaktuara në kapitullin "Kontrolli Tatimor", të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 dhe Manualit të kontrollit tatimor (bën rivlerësimet ligjore dhe vendos penalitetet përkatëse në zbatim të procedurave tatimore, si edhe nxjerr njoftim vlerësimin përkatës).

4. Nëse nga konstatimi i bërë rezulton se jemi në kushtet e përcaktuara në nenin 116, "Evazioni fiskal" të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, administrata tatimore në përputhje me pikën 2, të nenit 131,

“Veprat penale”, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe të Rregullores për bashkëpunimin mes funksioneve të veçanta të administratës tatimore, e raporton rastin në DHT në DPT, e cila pas verifikimit të saktësisë së procedurave të ndjekura, bën referimin penal në prokurori.

5. Pajisjet kompjuterike dhe/apo dokumentacioni tatimor, pas verifikimit dhe vlerësimit i kthehen tatimpaguesit me procedurë të rregullt administrative dorëzimi. Nëse rasti, relatohet në prokurori, pajisjet kompjuterike dhe dokumentacioni tatimor i sekuestruar administrohen për t’ju kaluar organeve të prokurorisë në cilësinë e provave material, pas kërkesës së kësaj të fundit.

6. Në çdo rast të konstatimit dhe sekuestrimit të pajisjeve kompjuterike jo fiskale, sipas nenit 127, pika 3, në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së tatimpaguesit, nga administrata tatimore, kryhet edhe konfiskimi i mallrave gjendje, në zbatim të procedurave tatimore sipas nenit 122, pika 1, germa h), të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore” i ndryshuar. Në çdo rast të tillë, përveç aktit të konstatimit mbahet edhe Procesverbal Konfiskimi të mallrave, duke cilësuar të specifikuar çdo artikull në njësi dhe në sasi.

6.1. Mallrat e konfiskuara administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Grupi i punës që ka kryer konfiskimin, merr masat që malli i konfiskuar t’i kalojë për administrim Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, e cila ndjek procedurat e mëtejshme ligjore.

6.2 Në rastin e konfiskimit të mallrave që nuk mund të magazinohen, prishen etj., si, ushqime, fruta-perime, produkte bujqësore dhe blektorale, produkte që kanë prag të afërt skadence, produkte që duan kushte specifike magazinimi etj. nga administrata tatimore mund të zbatohet riblerja në vlerë e tyre nga personi i tatueshëm. Për këte qellim, grupi i kontrollit i paraqet Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit ku është kryer shkelja proces-verbalin përkatës brenda 12 orësh nga plotësimi i tij. Drejtori i Drejtorisë Rajonale, brenda 24 orësh, nxjerr vendimin e vlerësimit në lekë të mallit të konfiskuar. Vlerësimi kryhet nga një komision i përhershëm i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, i përbërë nga jo më pak se 4 punonjës. Për vlerësimin e vlerës së mallrave zbatohen dispozitat e pikës 51.3 të këtij Udhëzimi. Vendimi për vlerësimin e mallrave të konfiskuar i jepet tatimpaguesit përkatës, i cili duhet të paguajë detyrimin, brenda ditës së parë të marrjes së tij. Paga bëhet në llogarinë e DRT të juridiksionit. Malli i konfiskuar lirohet vetëm pasi të jetë dorëzuar dokumenti që vërteton pagesën e vlerës së tij. Në dokumentacionin e konfiskimit depozitohet edhe një kopje e dokumentit të pagesë së vlerës së mallit të konfiskuar.

6.3 Në rast se, në momentin e konfiskimit tatimpaguesi bën kërkesë të menjëhershme për riblerje të mallrave të konfiskuar, DRT e juridiksionit ku është kryer konstatimi merr masat për vlerësimin e mallit si edhe për magazinimin e tij, deri në përfundim të procedurës së riblerjes. Kur magazinimi i tyre është i pamundur për shkak të volumit apo natyrës së mallit, administrata tatimore ka të drejtën edhe të sekuestrimit të mjeteve apo sendeve që kanë shërbyer ose që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për

kryerjen e kundërvajtjes administrative, sipas parashikimeve të nenit 11, të Ligji Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”.

7. Drejtoritë e Hetimit Tatimor në Rajone dhe DHT në DPT, si edhe Drejtoritë Rajonale Tatimore marrin masat organizative për njohjen e punonjësve të varësisë, me përmbajtjen e këtij Udhëzuesi dhe zbatimin korrekt të tij në praktikën e përditëshme të punës.

8. Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në zbatim të nenit 28, “Informimi i publikut”, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të publikojë këtë Udhëzues në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve: www.tatime.gov.al.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzuesi, shkresa nr. 19723 Prot., datë 17.07.2014, “Udhëzues në lidhje me zbatimin e nenit 127, pika 3, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 127.3 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Vasilika Vjetro

